

“Geoalbania Uno” shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 13

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Të tjera llogari të arkëtueshme	4	7,326,622	7,191,981
Total Aktive Afatshkurtra		7,326,622	7,191,981
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	5	38,472,183	37,433,002
Total aktive afatgjata		38,472,183	37,433,002
Total Aktive		45,798,805	44,624,983
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregëtare	6	1,850,972	1,398,977
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	7	-	24,614,980
Detyrime tatimore	8	8,371	8,371
Të tjera detyrime	9	25,880	73,560
Total Detyrime afatshkurtra		1,885,223	26,095,888
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	10	44,823,677	19,439,190
Total Detyrime afatgjata		44,823,677	19,439,190
Totali i detyrimeve		46,708,900	45,535,078
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	11	100,000	100,000
Rezerva të tjera		(1,010,095)	(1,010,095)
Total kapitali aksionar		(910,095)	(910,095)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		45,798,805	44,624,983

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-	-
Shpenzime të personelit	-	-
Të ardhura të tjera	-	-
Shpenzime financiare	-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	-
Fitimi/humbja e vitit	-	-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

“Geoalbania Uno” shpk
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nëshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Totali
Balance at 31 December 2013	100,000	(1,010,095)	(910,095)
Restated balance at 31 December 2014	100,000	(1,010,095)	(910,095)
Balance at 31 December 2015	100,000	(1,010,095)	(910,095)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Geoalbania Uno sh.p.k më 25.03.2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Massimo De Petro
Administrator

Mazars shpk
Hartuesi PAsqyrave Financiare

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(134,641)	(295,199)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	404,315	(750,059)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	269,674	(1,045,258)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(1,039,181)	(1,622,105)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(1,039,181)	(1,622,105)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	769,507	2,667,363
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	769,507	2,667,363
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	-	-
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "GEOALBANIA UNO" Shpk është regjistruar pranë QKR në 12/10/2010
Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 7638 dt. 19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti i saj.

"GEOALBANIA UNO" Shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Kapitali i shoqërisë "GEOALBANIA" Shpk është 100,000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 Leke secila,

"GEOALBANIA UNO" sh.p.k është një shoqëri e huaj me një ortak, GEOENERGIES S.P.A, zotërues të 100% të kuotave të kapitalit tëshoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është z. Massimo De Petro për periudhën nga 17/11/2013 deri në 17/11/2016.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Kati II, Tiranë, Shqipëri.
Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L02212002F.

Aktiviteti i shoqërisë është Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Progonat -Lekdush dhe "Bence e Siperme" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndertimi, venia pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike sipas Kontrates së Koncesionit Nr.1638 Rep,Nr.424/2 Kol,date 26.03.2009 e lidhur ndërmjet paleve,"Radici Energie" s.p.a dhe Ministrise se Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes

Shoqëria është në proces investimi dhe të gjitha kostot e periudhës i ka kapitalizuar në Punime në Proces.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23
GBP/LEK	186.59	179.48

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetes së dobishme të aktivitetit.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
TVSH e kreditueshme	7,326,622	7,191,981
	<u>7,326,622</u>	<u>7,191,981</u>

5. Aktivet Afatgjata materiale

Shoqëria është në fazë investimi. Gjithë kostot e periudhës janë kapitalizuar në punimet në proces, të paraqitura si më poshtë:

Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	<u>37,433,002</u>
Shtesa	<u>1,038,220</u>
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	<u>38,471,222</u>

6. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Furnitorë vendas	1,850,972	1,398,977
	<u>1,850,972</u>	<u>1,398,977</u>

7. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Llogari të pagueshme ndaj Geoenergjie	-	24,614,980
	<u>-</u>	<u>24,614,980</u>

8. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,371	8,371
	<u>8,371</u>	<u>8,371</u>

9. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj shoqërisë Mazars për financime afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Detyrim ndaj Mazars shpk	25,880	73,560
	<u>25,880</u>	<u>73,560</u>

10. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Të pagueshmet afatgjata ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Financim nga Geoenergie	44,823,677	19,439,190
	<u>44,823,677</u>	<u>19,439,190</u>

11. Kapitali aksionar

Kapitali i shoqërisë "GEOALBANIA" Shpk është 100,000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 Leke secila.

Gjatë vitit 2015 nuk ka pasur ndryshime në përzierjen dhe strukturën e kapitalit themeltar të shoqërisë.

12. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

13. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

